Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VII
Sesioni pranveror
Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit
Mbledhja nr.29
Prishtinë, më 11.12.2020, në orën 09:30
Salla N-302

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Shkëmb Manaj, Abelard Tahiri, Dimal Basha, Artan Abrashi, Alban Hyseni, Visar Hoti, ,Evgjeni Thaçi-Dragusha dhe Donika Kadaj- Bujupi.

Munguan: Abelard Tahiri, Endrit Shala dhe Ljubinko Kraraxhiq.

Pjesëmarrës tjerë: Shefki Kastrati-NDI, Aulona Sylaj-Ekonomiaonline, Agon Dreshaj, asistent dhe Blerim Sallahu-GP-LVV.

Stafi mbështetës i komisionit: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi: Shkëmb Manaj, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës

1. Propozimi dhe miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më datë 11.11 dhe 25.11.2020;
3. Shqyrtimi i propozimeve për zgjedhjen e 1 (një) anëtari të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe 2 (dy) anëtarëve të Komisionit për Verifikim dhe Vendosje për Prona;
4. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 07/L-029 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-089 për deminim humanitar;
5. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë me kandidatët për anëtarë dhe zëvendësanëtarë të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës;
6. Të ndryshme.

1. Propozimi dhe miratimi i rendit të ditës

Kryetari theksoi se pikë e gjashtë e rendit të ditës, bëhet propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 81 i kësaj rregulloreje dhe konstatoi se miratohet rendi i ditës, me ndryshimet e propozuara.

2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më datë 11.11 dhe 25.11.2020**

Kryetari konstatoi se u miratuan procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura, më datë 11.12.2020 dhe 25.12.2020.

3. **Shqyrtimi i propozimeve për zgjedhjen e 1 (një) anëtari të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe 2 (dy) anëtarëve të Komisionit për Verifikim dhe Vendosje për Prona**

Kryetari, tha se në këtë pikë është angazhuar grupi punues dhe për të sqaruar më shumë rreth kësaj çështjeje, fjalën ia dha deputetit Visar Hoti, si kryesues i grupit punues.

Visar Hoti, tha se sipas kompetencës, kryetari i Gjykatës për pozitën e 1 (një) anëtari të Komisionit për Kërkesa Pronësore, ka propozuar 2 kandidatë: Nadire Koshi dhe Korab Dibra. Kurse për pozitën e 2 (dy) anëtarëve të Komisionit për Verifikim dhe Vendosje për Prona, ka propozuar 3 kandidatë: Pranvera Alshiqi- Maloku, Albion Kelmendi dhe Gloriosa Hisari. Në këtë drejtim, z. Hoti citoi nenin 8 të paragrafit 2 të Ligjit nr. 05/L -010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, ku thuhet: " 2. KKP përbëhet nga tre (3) anëtarë. Një anëtar do të emërohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, pas propozimit nga kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.
Kurse neni 9, paragrafi 1 përcakton: "1. KVVP përbëhet nga pesë (5) anëtarë. Dy (2) nga anëtarët e KVVP emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, pas propozimit nga kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës", prandaj si grup punues kemi vlerësuar se nuk ka ndonjë pengesë ligjore, që të procedohet në Kuvend sipas propozimeve nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Deputeti Hoti vlerësoi se për pozitën e 1 (një) anëtari të Komisionit për Kërkesa Pronësore, ku janë propozuar 2 kandidatë: Nadire Koshi dhe Korab Dibra, është në rregull, kurse për pozitën e 2 (dy) anëtarëve të Komisionit për Verifikim dhe Vendosje për Prona, ku janë propozuar 3 kandidatë, tha se ka dilema sesi të procedohet tutje.

Alban Hyseni, meqë kanë ardhur tre propozime dhe jo katër, siç përcaktohet me ligj, konsideroj se nuk mund të votojmë këtë formë të propozimeve. Kjo ka qenë edhe vërejtja gjatë grupit të punës.

Evgjeni Thaçi-Dragusha, tha se është e vërtetë qe janë tre kandidatë për dy pozita dhe nuk ka asnjë pengesë, sipas ligjit, që të procedohet, por është praktikë e Kuvendit që për dy pozita të shkohet me katër kandidatë, megjithatë duke parë urgjencën e plotësimit të këtyre pozitave dhe duke parë mosinteresimin për aplikim për këto pozita, duhet të procedohen propozimet ashtu siç janë.

Kryetari theksoi se ligji nuk e obligon kryetarin e Gjykatës, në këtë rast, që të sjellë dyfishin e propozimeve, dhe meqë nuk ka ndalesa, do të ishte mirë që të procedohen këto propozime.

Alban Hyseni, propozoi që të kërkohet nga kryetari i Gjykatës Supreme, që të dërgojë edhe një emër, në mënyrë që propozimet të procedohen të kompletuara.

Kryetari kërkoi që të procedohet me pozitat e dy kandidatëve për Komisionin për Kërkesa Pronësore, ku të propozuar janë 2 kandidatë: Nadire Koshi dhe Korab Dibra, sepse tha se nuk ka asnjë pengesë ligjore, ndërsa për pikën tjetër, do t'i përcjellin shkresë kryetarit të Gjykatës Supreme, që të sjellë edhe një propozim.

Kryetari, tha se me pajtim të anëtarëve të komisionit, këto propozime mbetet që të shqyrtohen në një mbledhje të radhës, gjithashtu tha se do t'i përcillet shkresa kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ku kërkohet edhe një propozim shtesë për dy pozitat tjera.

4. Shqyrtimi i raportit të Komisionit funksional në Projektligjin nr. 07/L-029 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-089 për deminim humanitar

Kryetari paraqiti para deputeteve raportin e Komisionit funksional në Projektligjin nr. 07/L-029 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-089 për deminim humanitar dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit te deklarohen, nëse kanë vërejtje

Meqë nuk kishte diskutime, kryetari konstatoi se, me vota unanime, Komisioni vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr. 07/L-029 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-089 për deminim humanitar dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

5. **Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë, me kandidatët për anëtarë dhe zëvendësanëtarë të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës**

Visar Hoti, tha se në pajtim me vendimin e komisionit, të datës 25.11.2020, është formuar grupi punues për t'i shqyrtuar propozimet për anëtarë dhe zëvendësanëtarë të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës, dhe si grup punues kemi vlerësuar se disa nga kandidatët e propozuar nuk i plotësojnë kushtet për të qenë anëtar dhe zëvendësanëtar të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës, në pajtim me nenin 4, paragrafi 3. Në këtë drejtim, vlerësimi i grupit punues ishte se z.Dastid Pallaska dhe z. Mahir Tutuli nuk i plotësojnë kriteret e parapara me ligj, për të qenë pjesë e Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës. Po ashtu, znj. Shqipe Qerimi ka paraqitur dokumentacion të pamjaftueshëm, për ta arsyetuar kandidaturën e saj për pozitën e zëvendësanëares së komisionit, duke thënë se e njëjta ka përvojën e punës në sistemin e drejtësisë, që nga viti 2010, ndërsa pjesa tjetër e përvojës është jashtë sistemit të drejtësisë së Republikës së Kosovës.

Më pas, ai tha se grupi punues gjithashtu ka shqyrtuar edhe shkresën e Odës së Avokatëve, e adresuar përmes kryetares së Kuvendit, lidhur me mospërfshirjen e avokatëve në Komisionin për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës, dhe lidhur me këtë, grupi punues ka kërkuar sqarim nga Oda e Avokatëve, nëse dy avokatët e propozuar përfaqësojnë Odën e Avokatëve. Gjithashtu, lidhur me këtë, Oda e Avokatëve ka dhënë përgjigje se dy avokatët, Dastid Pallaska dhe Ilaz Ramajli, nuk janë propozuar nga Oda e Avokatëve, ashtu siç përcaktohet me statusin e odës, sqaroi deputeti Visar Hoti. Në fund, ai tha se në bazë të konstatimeve të lartcekura, i mbetet komisionit që të vendosë sesi të procedohet tutje.

Alban Hyseni, përtej konstatimeve në grup punues është ngritur edhe shqetësimi se z. Pallaska ka një vepër penale ose disa vepra penale. Pra, një rast për të cilin ai është akuzuar më herët, dhe në këtë drejtim, do të ishte mirë që të kërkohen sqarime nga institucionet përkatëse, që të mos lejohet futja e njerëzve që kanë aktakuza në procese të rëndësishme, por edhe të shkohet përtej kërkesave, që përveç vendimit të kërkohet edhe dokumentacion shtesë, që nuk është në ndjekje penale. Më pas, vazhdoi duke thënë se rasti tjetër ka të bëjë me znj. Shqipe Qerimin, e cila një pjesë të përvojës e ka në Preshevë, por tani është pjesë e sistemit të drejtësisë në Kosovë. Në këtë drejtim, ai tha se kjo është një çështje që duhet trajtuar me kujdes, në mënyrë që të definohet se a i ka të plotësuara kriteret në bazë të ligjit.

Kryetari, tha se në bazë të konstatimit, dy kandidatët, Dastid Pallaska dhe Mahir Tutuli, nuk i plotësojnë kriteret e parapara me nenin 4 paragrafi 3 i Ligjit për dhënien e provimit të jurisprudencës, ndërsa sa i përket Shqipe Qerimit, ai tha se në bazë të ligjit është përcaktuar sistemi i drejtësisë, por nuk është përcaktuar si sistemi i drejtësisë së

Republikës së Kosovës, pra është në rregull me kandidaturën e saj, përderisa nuk definohet në ligj**.**

Alban Hyseni, tha se nuk pajtohet me konstatimin e kryetarit, sepse duhet diskutuar edhe më tej përvoja, sepse derisa nuk ka rregullim të saktë ligjor në lidhje me këtë çështje, konstatimi duhet të jetë se e njëjta nuk i plotëson kriteret për të qenë pjesë e komisionit.

Kryetari, tha se duhet përcaktuar saktë se cilat janë kriteret që nuk plotësohen, sepse në bazë të kësaj logjike i bie që një qytetar i Republikës së Kosovës ka përvojë në sistemin e drejtësisë ndërkombëtare dhe në bazë të këtij neni nuk i lejohet që të jetë anëtar i Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës, ndërsa ligji nuk e kufizon. Më tej, ai tha se nëse ka pasur dilema tjera përtej përvojës së punës, grupi punues duhet ta sqarojë.

Visar Hoti, tha se nuk ka pasur dilema tjera, përveç dilemës se a njihet përvoja e punës jashtë sistemit të drejtësisë së Republikës së Kosovës. Megjithatë, nëse ligji nuk e përcakton, atëherë Shqipe Qerimi i plotëson kriteret e përcaktuara me ligj, duke konstatuar edhe njëherë se Dastid Pallaska dhe Mahir Tutuli nuk i plotësojnë këto kritere.

Evgjeni Thaçi-Dragusha, tha se këto propozime duhet të shkojnë në pako, me rekomandimin për ose kundër dhe të procedohet tutje.

Artan Abrashi, tha se nëse duhet të njohim përvojën e dikujt jashtë sistemit të drejtësisë në Kosovë, mendoj se krijohet precedent, sepse nuk e dimë se çfarë raste mund të ketë në të ardhmen, prandaj kur flitet për përvojën në sistemin e drejtësisë, kjo nënkupton përvojën në Kosovë, pra në kuadër të institucioneve tona.

Kryetari, tha se sa herë që Komisioni për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës ka kaluar në Kuvend, ka kaluar në kundërshtim me nenin, ku kërkohet 12 vjet përvojë pune në sistemin e drejtësisë. Kjo sepse secili komision ka pasur profesorë universitarë, të cilët nuk kanë pasur përvojë pune në sistemin e drejtësisë, prandaj mendoj se duhet të jemi korrekt edhe me raportin që do të paraqesim para deputeteve.

Visar Krasniqi, tha se komisioni është ngarkuar që të shqyrtojë propozim-vendimin dhe Kuvendit t'i paraqitet një raport me rekomandim për miratim ose për mosmiratim.

Kryetari, tha se kjo është mënyra më e mirë që mos ta rrezikojmë këtë komision, sepse që një kohë të gjatë nuk është organizuar provimi i jurisprudencës, sepse komisioni është jashtë mandatit.

Në fund, anëtarët e komisionit u dakorduan që të ketë një diskutim me ministrin e Drejtësisë, lidhur me konstatimet e grupit punues për propozimet për anëtarë të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës.

6. Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Punës së Kuvendit së Republikës së Kosovës, neni 81 të Rregullores së Kuvendit

Dimal Basha, si rrjedhojë e diskutimit në grup parlamentar, ai tha se te pika 4, ku ka dy alternativa, duhet të mbetet edhe pika b, ku secili deputet ta ketë të drejtën që të dërgojë amendamentet në seancë edhe pa mbështetje të komisionit.

Kryetari paraqiti para deputeteve 4 paragrafët e propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Punës së Kuvendit dhe kërkoi që anëtarët të deklarohen me votë, lidhur me këtë propozim-vendim.

Meqë nuk kishte diskutime tjera, kryetari konstatoi se komisioni, unanimisht, miratoi propozim-vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, nenit 81 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

PROPOZIM – VENDIM

për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 03-V-304, datë 29 prill 2010

Neni 1

Neni 81 i Rregullores së Kuvendit ndryshohet si vijon:

Neni 81

Miratimi dhe ndryshimi i Rregullores

1. Komisioni përkatës për Rregullore të Kuvendit apo së paku 6 (gjashtë) deputetë mund të propozojnë ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores në fuqi ose të ndërmarrin nismën për nxjerrjen e Rregullores së re të Kuvendit.

2. Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores në fuqi ose nxjerrjen e Rregullores së re të Kuvendit është procedurë e veçantë dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi dhe miratohet me dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Amendament mund të propozojë komisioni, grupi parlamentar dhe deputeti. Afati për parashtrimin e amendamenteve pranë komisionit përkatës për Rregullore të Kuvendit, është 15 ditë nga dita e njoftimit nga ana e komisionit përkatës për Rregullore të Kuvendit për nismën e ndërmarrë. Projekt-Rregullorja dhe njoftimi i komisionit iu shpërndahen të gjithë deputetëve.

4. Komisioni përkatës për Rregullore të Kuvendit, pas shqyrtimit të amendamenteve të propozuara, e përgatit raportin përfundimtar me amendamente dhe e procedon atë për shqyrtim në seancë plenare. Komisioni i përfshin të gjitha amendamentet e propozuara në raportin përfundimtar, me apo pa mbështetje të komisionit.

Neni 2
Hyrja ne fuqi

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendit i Republikës së Kosovës

7. Të ndryshme

Artan Abrashi, propozoi që të trajtohet kërkesa për ligjshmërinë e Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore, e cila i është adresuar komisionit, duke e konsideruar mjaft të arsyeshme.

Kryetari, tha se në një mbledhje të radhës do të trajtohet kjo çështje, ku i ftuar do të jetë edhe ministri i Drejtësisë.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30.
E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetar i komisionit,
Shkëmb Manaj